

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Lektor” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Mekanikës, për disipinat:

- **Dinamika e Vibrimeve në Makina, Shkenca e Konstruksioneve, Ndërtim Makinash.**

A. Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Lektor” pranë Departamentit të Mekanikës, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet “Master i Shkencave” në Inxhinieri Mekanike, profili Konstruksione dhe Mjete Lëvizëse ose ekuivalente me këtë profil;
2. Të kenë notë mesatare sipas kriterëve të Statutit të UPT-së për punësimin e personelit akademik;
3. Të kenë përfunduar studimet e doktoratës e të kenë marrë së paku gradën shkencore “Doktor” në departament ose në fushën e tij;
4. Të kenë eksperiencë në mësimdhënie në departament ose jashtë tij në këto fusha;
6. Preferohet të kenë pjesëmarrje në aktivitetin mësimor e shkencor të departamentit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje e dokumentit të gradës së fituar “Doktor” të noterizuar;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **08.04.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.